



**PROF. ASOC.
DR.ETLEVA DOBJANI**

Përgjegjëse
në Departamentin
e Arkitekturës

Lektore në
Fakultetin e Shkencave të Aplikuara
dhe Industrive Kreative

KONTAKTE

✉ arch.dep@umb.edu.al



**PROF. ASOC.
DR.ETLEVA DOBJANI**

Përgjegjëse
në Departamentin
e Arkitekturës

Lektore në
Fakultetin e Shkencave të Aplikuara
dhe Industrive Kreative

BIOGRAFIA

Etleva Dobjani, Prof. Asoc. Dr., është arkitekte dhe urbaniste, Lektore dhe Përgjegjëse e Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit në Universitetin Barleti. Përveç kontributit në fushën akademike, ajo luan rol kyç në disa nisma të rëndësishme, përfshirë koordinimin e Trienales së Arkitekturës në Tiranë, menaxhimin e projekteve New Cross National Temporality dhe LINA, dy projekte me financime të Creative Europe, ArkiLab, dhe koordinimin e konferencave shkencore ndërkombëtare Future Smart City dhe Urban Regeneration and Sustainability, të indeksuara në SCOPUS. Midis angazhimeve të ndryshme brenda departamentit, ajo ndjek edhe procesin e diplomave në nivelin e Master shkencor dhe koordinon projektet Erasmus + në nivel departamenti.

Prof. Asoc. Dr. Dobjani është përfshirë aktivisht në organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe gjithashtu kontribuon si anëtare e komitetit shkencor ose anëtare e jurisë në konkurse ndërkombëtarë. Ajo është diplomuar për arkitekturë në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë në Politeknikun e TORINOS në vitin 2008, ITALI. Ajo gjithashtu mori një diplomë master i nivelit të dytë nga Universiteti POLIS në bashkëpunim me Universitetin Erasmus të Rotterdamin në Hollandë, në vitin 2011, dhe në vitin 2016, ajo mori titullin Doktor i Shkencave nga Universiteti La Sapienza, në ROMË, ITALI, në Departamentin e Arkitekturës, Teorisë dhe Projektit. Që nga 2023, ajo është Profesore e Asociuar. Përtej fushës akademike, ajo ka punuar në Studio Arkitekture si arkitekte dhe është aktive si Auditore Energjitike dhe Menaxhere Energjie në Shqipëri. Përgjatë karrierës së saj, ajo ka marrë pjesë në projekte të ndryshme kërkimore me fokus në trashëgiminë kulturore, restaurimin, eficientë energjitike, rigjenerimin urban dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke ndërtuar reputacionin e saj si një figurë e shquar në fushat e arkitekturës dhe urbanistikës..